



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:032868

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06735157

C.nr.59/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen kontestimore të paditësit A. S. nga L., të cilin e përfaqëson Kimete Sahiti av. nga Lipjani, me autorizim, ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të kompensimit të dëmit retroaktiv lidhur me koeficientin, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, me dt.13.01.2025, gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET SI E PALEJUAR padia e paditësit A. S. nga L. ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit, në këtë çështje juridiko-civile, për shkak të inkompetencës absolute.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A. S. nga L. në këtë gjykatë përmes të autorizuares të tij, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit, për shkak të kompensimit të dëmit retroaktiv lidhur me koeficientin.

Në padi ka theksuar se paditësi është në mardhënje pune në kohë të pacaktuar tek e paditura prej 09.07.2013 në Drejtorin e Inspektoratit, në punë dhe detyrat e punës si inspektor i Mjedisit dhe Ambientit në Komunën e Lipjanit dhe vazhdon të punoj në të njëjtën pozitë me orar të plotë sipas Akt emërimit së punës Nr.1-031-7555 të datës 08.07.2013 me koeficient 6 deri me datën 23.12.2022. Paditësi tek e paditura ka ushtruar kërkesë nr.01-120/01-6330 të datës 24.11.2022 për ndryshimin e koeficientit në listën e pagave dhe kompozimin në mënyrën retroaktive për pagat e pa realizuar gjatë periudhës së mardhanjës së punës prej koeficientit 6 në 8 sipas referencës DASHC/MAP-04/1571 të datës 20.11.2014 nga Ministria e Administratës Publike. E paditura në përgjigjen e kërkesës lidhur me aprovimin për ndryshim të koeficientit për paditësin si dhe për zyrtaret e administratës Komunale të Lipjanit duke paraparë edhe strukturat organizative të administratës komunale si dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2023 ju ka drejtuar me shkresë zyrtare në DMZP-së, por nuk kanë marr përgjigje, duke mos e ditur se ka pasur shkresë zyrtare nga MAP, Departamenti i Administratës të Shërbimit Civil lidhur me vendosjen e koeficientit sipas pozitës përkatës. Paditësi i pakënaqur me përgjigjen nga ana e të paditurës ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 07.12.2022, me të cilën e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe e ka obliguar të paditurën që brenda afatit prej 15 ditësh nga data e pranimit të vendimit për harmonizimin e koeficientit të

paditësit nga koeficienti 6 në koeficientin 8 të pagës. Me datën 17.01.2023 paditësi ka paraqitur kërkesën të e paditura për kompensimin e pagës në mënyre retroaktive për pjesën e humbur në vlerën e 2 koeficienteve nga viti 2014 e deri me 31.12.2022, e paditura në përgjigjen e saj e ka refuzuar kërkesën e paditësit si të pa bazuar me arsyetimin se realizimi i koeficientit vlen vetëm nga vendimi i KPMSHC sa i përket ngritjes së koeficientit e jo për kompensimin e pagës retroaktive nga viti 2014 prej vendosjes së DASHC/MAP-04/1571 datës 20.11.2014, ku e paditura ka përgjegjësi ligjore që paditësit t'ia bëjë kompozimin në mënyrë retroaktive për 2 koeficienta prej periudhës 11.12.2014, andaj për këtë arsye e në pajtim me dispozitat e Ligjit për Pagat e Nënpunësve Civil, kompensimi i pagës dhe pagesave tjera, kompensimi e dëmit fitimit e humbur, pagesat të tjera në rrethana të veçanta, për detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me Ligjin e Punës dhe me kontratën e punës t'ia paguaj shumën e kërkuar në lartësinë e cila do të vërtetohet edhe me ekspertizë financiare.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se në këtë çështje kontestimore të ngritur nga ana e paditësit nuk kemi të bëjmë me të ardhura personale nga marrëdhënia e punës por kemi të bëjmë me kërkesën e paditësit për ndryshimin e koeficientit të pagës, andaj me të vërejtur këtë gjykata konstaton se paditësi nëse ka qenë i pa kënaqur me vendimin administrativ përfundimtar ku i është refuzuar kërkesa për ndryshimin e koeficientit është dashur të inicoj konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë në Departamentin Administrativ, andaj nga këto arsye gjykata konsideroj se rasti në fjalë nuk bie në kompetencën gjyqësore por është çështje administrative dhe për këtë e hudhi posht padinë si të pa lejuar ngase kemi të bëjmë me inkompetenc absolute.

Në bazë të nenit 50 par.1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës me të cilin parashifet se “Nënpunësit civil kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me mardhënien e tyre të punës” ndërsa me par. 2 po të të njëjtit nen parashifet se “Nënpunësit civil kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkelje të të drejtave të tyre, që rezultojnë nga një veprim i administratës publike”.

Gjithashtu sipas neni 78 të LSHC parashifet se “Nënpunësi civil i nivelit të lartë drejtues i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit për vendimin”. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit administrativ, pala e pakënaqur mund të fillojë procedurën administrative për zgjidhjen e kontestit në gjykatën kompetente në Kosovë, në pajtim me nenin 43 të këtij Ligji dhe me Ligjin mbi Procedurën Administrative”.

Me dispozitat e nenit 18.1 të LPK-së parashihet se “Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare gjatë gjithë procedurës nëse zgjidhja e kontestit hyn ose jo në kompetencën e gjykatës, ndërsa me par. 2 të po të njëjtit nen dhe Ligj parashifet se “Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata por është ndonjë organ tjetër shtetëror, do të shpallet inkompetente, do të shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur.

Pra, nga dispozitat e lartpërmendura dhe bazuar në gjendjen e pretenduar të paditësit me padi gjykata vjen në përfundim se nuk ka kompetenc për të gjykuar rastin konkret sepse ndryshimi i koeficientit të paditësit si nënpunës i të paditurës është çështje administrative dhe nëse ka qenë paditësi ipa kënaqur me vendimin administrativ siç është udhëzuar në aktin

administrativ është dashur të inicoj konflikt administrativ dhe se për gjykatën kjo çështje është jo kompetente në pikëpamje absolute, andaj gjykata e hudhi posht padinë si të pa lejuar.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN
C.nr.59/23 me dt.13.01.2025

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njejtit, përmes kësaj gjykate.